



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 08.08.2025

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 37, te Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi : 632-19-7343-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-19-090-521 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-22322, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, me dt.08.08.2025, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM

Për ndërprerjen të Kontratës

1. Për shkak të dështimit për të përmbushur obligimet kontraktuale, që parqet element thelbësorë të kontratës, kontrata me numër te prokurimit : 632-19-7343-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-19-090-521 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-22322, e nënshkruar me datën 01.10.2020, me titull “ Rivitalizimi i Eshnores-Çabrat në Gjakovë-Kontratë dy vjeçare”, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Company"Bejta Commerce" SH.A & Eurocom shpk & King Holding shpk - Gjilan,, **NDËRPRITET**.
2. Për shkak se kryesi i punëve Company"Bejta Commerce" SH.A & Eurocom shpk & King Holding shpk - Gjilan, është përgjegjës për mos përmbushje të obligimeve që dalin nga kontrata, obligime këto që janë kusht esenciale dhe themelor i kontratës, **NDËRPRITEN** së vepruari te gjitha raportet dhe marrëdhëniet Autoritet Kontraktues – Kryes i punëve , të rregulluara me Kontratën me numër te prokurimit: 632-19-7343-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-19-090-521 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-22322, e nënshkruar me datën 01.10.2020, për çka Autoriteti Kontraktues, do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.
3. Me qëllim të kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga veprimet e pajustificuara të Furnizuesit, Autoriteti Kontraktues do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin e prokurimit për “Rivitalizimi i Eshnores-Çabrat në Gjakovë-Kontratë dy vjeçare”, në mes të Komunës së Gjakovës dhe Punë kryesit Company"Bejta Commerce" SH.A & Eurocom shpk & King Holding shpk - Gjilan, për kryerjen e punëve të kontraktuara sipas Kontratës.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës së dërguar në Zyrën e Prokurimit me datë 04.08.2025, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen e Kontratës.


Me datë 07.08.2025, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar “Njoftimin për ndërprerje të kontratës” të kryesi i punëve Company"Bejta Commerce" SH.A & Eurocom shpk & King Holding shpk - Gjilan.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini



Kryetari i Komunës



Faton Gutaj



Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
Menaxherit të kontratës;
Organit Mbikëqyrës;
Arkivës së Komunës.